



**Arritje dhe suksese
të GjH-UT
2021-2024**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA



Strategjia e Zhvillimit të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja
2021-2024

Miratuar me Vendimin e Dekanatit
Nr. 150 datë 21.12.2021

Dhjetor 2021



Strategjia e Zhvillimit të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja 2021-2024 është miratuar me Vendim Dekanati nr. 150 datë 21.12.2021

Zbatimi i kësaj strategjie u realizua nga bashkimi i energjive të brendshme të stafit akademik, administrativ dhe studentëve të Fakultetit në bashkëpunim me Rektoratin dhe strukturat e UT-së, me mbështetjen e partnerëve të shumtë kombëtarë, ndërkombëtarë të sferës universitare, të shoqërisë civile, të komunitetit dhe të biznesit.

Në vijim detajohen:

- Objektivat e vendosura;
- Rezultatet e arritura.



1. Organizimi dhe drejtimi efektiv

Përmirësimi i kuadrit rregullator dhe aktivizimi i njësive mbështetëse

Veprimet imediate

Brenda vitit 2021 u realizua aktivizimi dhe ngritja e strukturave mbështetëse si dhe u krye zgjedhja e personelit ndihmës akademik e administrativ. Gjithashtu u ndërmorën hapa për hartimin dhe miratimin në Dekanat të akteve rregullatore të munguara.

Aktivizimi i njësive mbështetëse

1. Dega e Cilësisë Vlerësimit dhe Kurrikulës
2. Dega e Kualifikimit Shkencor dhe Botimeve
3. Dega e Projekteve
4. Dega e Këshillimit të Karrierës
5. Dega e Trajnimeve dhe Inovacionit Pedagogjik
6. Dega e Përkthimeve
7. Zyra e WEB dhe IT
8. Dega e Psikologut

Dokumentacioni i miratuar

1. Strategjia e Zhvillimit të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja;
2. Strategjia e Ndërkombëtarizimit;
3. Strategjia e Teknologjisë dhe Inovacionit në Mësimdhënie e Nxënie;
4. Strategjia e Gjithpërfshirjes së Studentëve me Aftësi Ndryshe në FGjH;
5. Strategjia dhe Politikat e Marketingut të FGjH;
6. Politikat e FGjH për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Mjedisit;
7. Studimi i Tregut të Punës për Studentët e FGjH;
8. Rregullore Diplomimi e Programeve Studimore të Ciklit I Bachelor;
9. Rregullore Diplomimi e Programeve Studimore të Ciklit II Master;
10. Manuali i Praktikës Profesionale për Studentët e Ciklit II Master;
11. Rregullore për Organizimin e Programit të Studimit të Doktoratës në FGjH;
12. Rregullore për Funksonimin e Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë;
13. Rregullore për organizimin dhe funksionimin e grupeve mësimore-kërkimore dhe kërkimore-mësimore në FGjH;
14. Rregullore për Organizimin e Konferencave;
15. Rregullore për mbrojtjen e gjuhëve;
16. Rregullore e Brendshme për Funksonimin e Administratës së FGJH.



2. Formulimi i planit financiar, që mbështet zhvillimin institucional

Mbështetja financiare për kërkimin shkencor dhe diversifikimi i burimeve financiare

Aktivizimi i qendrës së gjuhëve të huaja dhe ofrimi i shërbimeve për të tretët

Në 2021, në përputhje me standardet e Këshillit të Evropës, u realizua unifikimi i certifikatave që lëshohen nga FGjH-UT për mbrojtjen e gjuhëve të huaja si shërbim që ofrohet ndaj të tretëve dhe sipas kalendarit të publikuar: A1; A2; B1; B2; C1; C2.




Ngritja e qendrës së trajnimeve si shërbime ndaj të tretëve

Në 2022, FGjH ka fituar të drejtën e ofrimit të trajnimeve me 1, 2, 3 kredite për 10 module të akredituara nga ASCAP dhe licensuar nga MAS, si shërbim që ofrohet ndaj punonjësve të arsimit parauniversitar dhe sipas kalendarit të publikuar.

Apliko	Date/Ore Trajnimi	Agjensia	Moduli	Kategoria	Kredite
	Jun 25, 2024, 2:00:00 PM	Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja	PERKRAHJA E DIVERSITETIT	Gjithëpërfshirja	1
	Jun 25, 2024, 2:00:00 PM	Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja	PERDORMI I PLATFORMES VIRTUALE NE MESIMDHENIE (TEAM, OFFICE 365)	TIK në mesimdhënie dhe nxënësi	2
	Jun 25, 2024, 2:00:00 PM	Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja	INTEGRIMI I KONCEPTEVE TE BARAZISE QJINORE NE MESIMDHENIE	Gjithëpërfshirja	1
	Jun 25, 2024, 2:00:00 PM	Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja	MENAXHIMI I KLASES DHE I KONFLIKTEVE, MIREGJENIA E NXENESVE NE KLASE	Etika, komunikimi dhe pedagogjia	2
	Jun 25, 2024, 2:00:00 PM	Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja	TESTIMI DHE VLERESIMI I TE NXENIT SI DHE NXITJA E AUTONOMISE SE NXENESIT BAZUAR NE PORTFOLIN PEGJH	Mësimdhënia dhe të nxënësit	3
	Jun 24, 2024, 2:00:00 PM	Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja	MESIMDHENIA DHE TE NXENIT BAZUAR NE KOMPETENCA DHE PLANIFIKIMI I VEPREMTARJEVE MESIMORE SIPAS NEVOJAVE TE VEÇANTA DHE NIVELEVE TE NDRYSHME MESIMORE	Gjithëpërfshirja	3
	Jun 24, 2024, 2:00:00 PM	Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja	MESIMI DHE VLERESIMI I NXENESVE NEPERMIET APLIKACIONEVE KAHOOT, MENTIMETER, QUIZLET	TIK në mesimdhënie dhe nxënësi	1
	Jun 21, 2024, 2:00:00 PM	Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja	PERDORMI I PLATFORMES VIRTUALE NE MESIMDHENIE (CLASSROOM, ZOOM, BLOGGER) DHE NE DISTANCE	TIK në mesimdhënie dhe nxënësi	1
	Jun 21, 2024, 2:00:00 PM	Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja	HARTIMI DHE REALIZIMI I NJE PROJEKTI NE MESIMDHENIEN NE KLASE DHE NE DISTANCE	Mësimdhënia dhe të nxënësit	1
	Jun 21, 2024, 2:00:00 PM	Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja	TEKNIKAT E TE PYETURIT DHE DISKUTIMI	Mësimdhënia dhe të nxënësit	2

Ngritja e qendrës së përkthimeve

Në 2023 është aktivizuar qendra e përkthimeve e cila merret me përkthimin në gjuhën angleze të rregulloreve, udhëzuesve si dhe Faqen Web zyrtar të FGjH-UT.






3. Ndërtimi i markës dhe identitetit për promovimin e Fakultetit

Krijimi i një sistemi gjithpërfshirës së identitetit vizual dhe veprues

Plani strategjik i markës

- ✓ Me fillimin e vitit akademik 2021-2022 për herë të parë studentët e rinj u pajisën me Udhërrëfyesin FGjH dhe materiale promovuese të loguara "FGjH-UT".
- ✓ Janë përpiluar broshura dhe fletëpalosje me programet e ofruara nga FGjH-UT edhe në gjuhën angleze.
- ✓ U ideua dhe realizua modeli i ri i website FGjH-UT në shqip dhe anglisht, i cili përditësohet në kohë me çdo aktivitet akademik dhe kulturor duke evidentuar rezultatet e arritura të personelit akademik dhe studentëve;
- ✓ Janë çelur media sociale elektronike që kanë nxjerr në pah punën produktive të personelit akademik dhe studentëve të FGjH-UT;
- ✓ Në nëntor 2021 është ngritur rrjeti i ambasadorëve të markës "Alumni" duke bërë aktiv bashkëpunimet me profesionistë të afirmuar.




4. Vendorsja e studentëve në qendër të veprimtarisë së Fakultetit




Aktivite me fokus mbështetjen e studentëve

Me fillimin e vitit akademik 2021-2022 dhe veçanërisht me ngritjen e Zyrës së Këshillimit të Karrierës, janë organizuar shumë aktivitete me fokus mbështetjen e studentëve nga ana akademike dhe profesionale si dhe duke i bërë ata pjesë të eventeve gjithëpërfshirëse.



Risi: Promovimi i programeve të studimit bachelor

Duke filluar nga viti 2022 është realizuar një plan pune për promovimin e programeve të studimit bachelor nëpërmjet: Panairit Work & Study, Open Days, informimi në shkollat e mesme, takime *online* me maturantët si dhe prezenca e personelit akademik në mediane dhe shkruar dhe atë televizive.



Universiteti i Tiranës
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Je maturant dhe ke dëshirë të studiosh në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja?

Merr pjesë në takimet online për t'u njohur me programet e studimit dhe mundësitë që ofron Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

- 23 Shkurt 15:00 Anglisht - Italisht
- 2 Mars 15:00 Anglisht - Frëngjisht
- 9 Mars 15:00 Gjermanisht - Rusisht
- 16 Mars 15:00 Turqisht - Spanjisht
- 23 Mars 15:00 Greqisht - Anglisht
- 30 Mars 15:00 Frëngjisht - Italisht

#tespresimnefjth #fakultetiverteteuropian



Promovimi i programeve të studimit master

Me studentët e vitit II e III bachelor në FGJH është realizuar promovimi i programeve të studimit master ekzistuese dhe atyre të reja nëpërmjet ditëve të informimit me takime në auditor, leksione të hapura me mësues të shkollave të mesme, për të promovuar këtë profesion dhe duke mbajtur lidhje më afër me ta.



PROMOVIMI I PROGRAMEVE TË "MASTER I SHKENCAVE DHE PROFESIONAL" NË FAKULTETIN E GJUHËVE TË HUAJA

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja organizon "Javën e Informimit të Studenteve për programet e ciklit të dytë master, për vitin akademik 2023-2024 të ofruara nga FGJH:

- Master i Shkencave në "Mësuesi në gjuhën e huaj, për arsimin e mesëm dhe të lartë";
- Master i Shkencave në "Përkthim-Interpretim Teknik dhe Letrar";
- Master i Shkencave në "Gjuhë dhe Komunikim Ndërkulturor e Turistik";
- Master Profesional në "Përkthim" me Profil Përkthyes;
- Master i Delokalizuar në "Përkthim Profesional" ITIRI Francë;
- Master i Shkencave në "Trajtimi Informatik dhe Gjuhësor i Dokumentave të Shkruara"

Kalendari i takimeve me studentët:

Data	Ora	Auditori
18.04.2023	10:30 – 11:00	Salla "Evropa"
19.04.2023	11:30 – 12:00	Salla "Evropa"
20.04.2023	12:30 – 13:00	Salla "Evropa"

DITË INFORMIMI PËR STUDENTËT E VITIT TË II DHE TË III BACHELOR

- INFORMIM MBI PROGRAMET E CYKLIT TË DYTË-MASTER QË FGJH OFRON;
- TAKIM ME KOORDINATORIN ERASMUS+ PËR T'JU INFORMUAR NË LIDHJE ME APLIKIMET DHE DOKUMENTACIONIN PËRKATËS;
- PREZANTIM ME SHËRBIME TË TJERA QË FGJH OFRON:
QËNDRA E KURSEVE;
ZYRA E CILËSISË DHE KURRIKULAVE;
ZYRA E KËSHILLIMIT TË KARRIERËS;
ZYRA E PROJEKTEVE;
KLUBET STUDENTORE.

**DATË 13.12.2022
ORA 10:00
SALLA
"EVROPA"**

DITA EVROPIANE E GJUHËVE

"Promovimi i mësimit të gjuhëve të huaja gjatë gjithë jetës si vektorë të rëndësishëm të edukimit qytetar dhe të suksesit profesional"

**26.09.2023
Ora 10:00
Salla "Evropa"**

@fakulteti.gjuhevetehuaja.ut www.fgjh.edu.al

Zgjidh Masterin tënd në FGJH

- Master i Shkencave në "Mësuesi në Gjuhë të Huaj për Arsimin e Mesëm dhe të Lartë"
- Master i Shkencave "Përkthim dhe Interpretim Letrar"
- Master i Shkencave "Gjuhë dhe Komunikim Ndërkulturor dhe Turistik"
- Master i Delokalizuar me Universitetin e Strasburgut në degën "Përkthim Profesional"
- Master Profesional në "Përkthim me Profil "PËRKTHYES" në Gjuhën Angleze"

DIPLOMË E DYFISHTË MASTER ME UNIVERSITETIN SORBONNE PARIS NORD
FUSHA : TRAJTIMI AUTOMATIK I GJUHËVE
DREJTIMI: TRAJTIMI INFORMATIK DHE GJUHËSOR I DOKUMENTEVE TË SHKRUARA

@fakulteti.gjuhevetehuaja.ut


Universiteti i Tiranës
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja
PROGRAMI
JAVA E ORIENTIMIT TË STUDENTËVE TË RINJ
VITI AKADEMIK 2023-2024

DATA 1  **Data 02.10.2023**  **Salla "Evropa"**

Takim me personelin Drejtues të FGJH-së dhe stafin Akademik të Departamenteve përkatësisht sipas gjuhëve:

- Ora 09:00 – Departamenti i Gjuhës Angleze – Auditori 307
- Ora 09:30 – Departamenti i Gjuhës Gjermane – Auditori 209
- Ora 10:00 – Departamenti i Gjuhës Italiane – Auditori 309
- Ora 10:00 – Departamenti i Gjuhës Frënge – Auditori 207
- Ora 10:30 – Departamenti i Gjuhës Spanjolle – Auditori 312
- Ora 10:30 – Departamenti i Gjuhës Greke – Auditori 204
- Ora 10:30 – Departamenti i Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike – Auditori 112

DATA 2  **Data 03.10.2023**  **Ora 09:30**  **Salla "Evropa"**

Takim me:

- Përfaqësuesen e Zyrës së Këshillimit të Karrierës;
- Përfaqësuesen e Zyrës së Cilësisë dhe Kurrikulës;
- Përfaqësuesen e Qendrës së Trajtimeve;
- Përfaqësuesen e Zyrës së Projekteve;
- Përfaqësuesit e Zyrës së IT;
- Orientim i studentëve me mjediset e FGJH-së, njohje me laboratorët, bibliotekat dhe sallat e leksioneve.



Risi: Java e orientimit për studentët e rinj




JAVA
E ORIENTIMIT PËR
STUDENTËT E RINJ

1  **Data 17.10.2022**

Takim me Dekanin e FGJH-së dhe stafin Akademik të departamenteve përkatësisht sipas gjuhëve:

- Ora 09:00 - Gjuha Angleze - Auditori 309
- Ora 09:30 - Gjuha Gjermane - Auditori 307
- Ora 10:00 - Gjuha Italiane - Auditori 209
- Ora 10:30 - Gjuha Frënge - Auditori 207
- Ora 11:00 - Gjuha Spanjolle, Greke, Turke, Ruse - Auditori 209

2  **Data 18.10.2022**

Ora 09:30 - Auditori "EVROPA"

- Takim me përfaqësueset e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Zyrës së Cilësisë & Kurrikulës për informacione të vlefshme gjatë vitit akademik;
- Orientim për mjediset e FGJH-së, njohje me laboratorët, Bibliotekat dhe sallat e leksioneve.

3  **Data 19.10.2022**

Ora 09:30 - Auditori "EVROPA"

- Takim me Këshillin Studentor të FGJH-së për t'u njohur me organizimin e studentëve në fakultet.

4  **DATA 20.10.2022**

Ora 09:30 - Auditori "EVROPA"

- Takim me Koordinatorët e Klubeve Studentore të FGJH-së dhe informimi mbi aktivitetet që zhvillohen përgjatë vitit akademik.

5  **DATA 21.10.2022**

Ora 09:30 - Auditori "EVROPA"

- Studentët e ERASMUS+ ndajnë përvojën e tyre me studentët e rinj;
- Takim me Koordinatorin Akademik ERASMUS+, për t'u informuar në lidhje me aplikimet dhe dokumentacionin përkatës.

JU UROJMË MIRËSEARDHJEN NË FGJH!

Panairi i Punës



UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË

PANAIRI I PUNËS

- MUNDËSI PUNËSIMI
- INTERSHIPE DHE TRAJNIME
- INTERVISTA
- KËSHILLIM KARRIERE

KËRKO SOT NJË TË ARDHMË TË BUKUR

DATË 26.05.2022

UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË

PANAIRI I PUNËS

- MUNDËSI PUNËSIMI
- INTERSHIPE DHE TRAJNIME
- INTERVISTA
- KËSHILLIM KARRIERE

Zgjidh punën tënde!

ORA 10:00
DATË 12.05.2023

UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË

PANAIRI I PUNËS

10:00am
18 PRILL 2024
Oborri para Fakultetit

Mundësi Punësimi
Intershipe dhe Trajnime
Intervista
Këshillim Karriere

Zgjidh Punën Tënde

www.fgjh.edu.at



Shkollat verore/dimërore





Winter School Certificate and Chinese Painting Giving Ceremony

06.06.2022 10:00
SALLA EVROPA


10:00 - 10:05 PROF. DR. ESMERALDA KROMIDHA, DEAN OF THE FACULTY OF THE FOREIGN LANGUAGES

10:05 - 10:10 HE MR. ZHOU DING, AMBASSADOR OF THE PEOPLE'S REPUBLIC OF CHINA TO THE REPUBLIC OF ALBANIA

10:10 - 10:30 WINTER SCHOOL CERTIFICATE AWARDING CEREMONY

10:20 - 10:30 PAINTING GIVING CEREMONY

10:30 COFFEE BREAK



Mbështetja e veprimtarive të Këshillit Studentor

Mbështetje në nismat e studentëve si edhe në aktivitete të organizuara nga vet fakulteti për të mbështetur jetën studentore me konferenca shkencore për studentët, revistën e tyre, leksione të hapura e trajnime të vazhdueshme.



Universiteti i Tiranës
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

**TAKIM ME KËSHILLIN
STUDENTOR TË FAKULTETIT
TË GJUHËVE TË HUAJA**

DEBATING
ECONOMICS

PHOTO: A group of students and faculty members standing together, and a student presenting at a podium.



KËSHILLI STUDENTOR I FAKULTETIT
TË GJUHËVE TË HUAJA ORGANIZON:

**KONFERENCA
STUDENTORE**

TË NXËNIT NË SHEK. XXI,
PROBLEMATIKAT DHE PERSPEKTIVAT

DATA TË RËNDËSISHME:
DORËZIMI I ABSTRAKTEVE: 30.04.2022
NJOFTIMI I PRANIMIT: 07.05.2022
DATA E KONFERENCËS: 12.05.2022

Akset e konferencës:
•Gjuhësi e komunikim
•Didaktika e gjuhëve të huaja
•Letërsi
•Përkthim/interpretim
•Zhvillimi i qasjeve të reja të kërkimit

Për të aplikuar skanoni barkodin ->



Trajnime për fuqizimin e kompetencave profesionale të studentëve



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEGA E TRAJNIMEVE DHE INOVACIONIT PEDAGOGJIK



Kalendari i Trajnimeve të Studentëve për vitin akademik 2023-2024



Trajnimet zhvillohen në auditor dhe online

Nr	Data	Ora	Temat e Trajnimit
1	09.10.2023	13:30-15:30	Paisja me emailin zyrtar dhe vënia e tij në përdorim (për vitin e parë) Informimi mbi përdorimin e sistemit informatik, e-Student.
2	16.10.2023	13:30-15:30	Njohja dhe përdorimi i aplikacioneve të inteligjencës artificiale (AI) Përdorimi i ChatGPT për qëllime didaktike.
3	06.11.2023 07.11.2023	13:30-15:30 13:30-15:30	Teknikat e menaxhimit të kohës dhe praktikat produktive në marrjen e shënimeve në auditor.
4	04.12.2023 05.12.2023	13:30-15:30 13:30-15:30	Zhvillimi i aftësive të shkrimit akademik duke i ndihmuar studentët të zhvillojnë një përvojë të suksesshme në mësimnxënie dhe hulumtim.
5	11.01.2024	13:30-15:30	Menaxhimi i stresit: Teknikat për ta trajtuar dhe menaxhuar duke përfshirë teknika të qetësisimit dhe mënyra për të ruajtur mirëqenien emocionale.
6	12.02.2024 13.02.2024	13:30-15:30 13:30-15:30	Qasja në mësimdhënie me projekte dhe zgjidhja e problemeve.
7	19.02.2024	13:30-15:30	Ndërtimi i marrëdhënieve dhe aftësive sociale për ndërveprimin dhe bashkëveprimin në një mjedis social dhe profesional.
8	04.03.2024	13:30-15:30	Planifikimi i karrierës, zhvillimi dhe ndërtimi i njehjes së kontakteve.
9	03.04.2024	13:30-15:30	Teknika e komunikimit për ndërveprim profesional.
10	22.04.2024	13:30-15:30	Menaxhimi i financave personale dhe arti i investimeve.
11	02.05.2024	13:30-15:30	Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies.

Universiteti i Tiranës
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Elite Travel Group

STRATEGJITË E MARKETINGUT DIGJITAL NË INDUSTRIJËN E TURIZMIT

26.02.2024 12:30
Salla "Evropa"

Universiteti i Tiranës
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja
Dega e Trajnimeve dhe Inovacionit Pedagogjik

zhvillon trajnimin për studentët me temë:

"PAISJA ME E-MAIL ZYRTAR DHE VËNIA E TIJ NË PËRDORIM"
"INFORMIMI MBI PËRDORIMIN E SISTEMIT INFORMATIK E-STUDENT DHE PLATFORMËN TEAMS"

09.10.2023 Ora 13:30 Salla "Evropa"

UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
GJENDRA E TRAJNIMEVE FOJH

Zyra e Trajnimeve e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja do të ofrojë trajnimin:

NDIKIMI I NEUROSHKENCËS DHE NEUROGJUHËSISË NË KRIJIMIN E MARRËDHËNIEVE POZITIVE NË MËSIMDHËNIEN POST COVID 19
nga Prof. Dr. Shpresa DELIJA

SALLA EVROPA
DATA 05.05.2022
ORA 10:00 - 12:00

Universiteti i Tiranës
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Turizmi i Qendrueshëm në Shqipëri
LEKSION I HAPUR

Elite Travel Group
Gebeco
13.02.2024
08:30-09:30
SALLA "EVROPA"

Universiteti i Tiranës
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja
Dega e Trajnimeve dhe Inovacionit Pedagogjik

NJOHJA DHE PËRDORIMI I APLIKACIONEVE TË INTELIGJENCËS ARTIFICIALE(AI)
PËRDORIMI I CHATGPT PËR QËLLIME DIDAKTIKE

30.10.2023
Ora 13:30
Salla "Evropa"

Përmirësimi i jetës akademike dhe kulturore për studentët


Përmirësimi i jetës akademike dhe kulturore të studentëve tanë, duke i vendosur ata në qendër të veprimtarive mësimore me një theks në partneritetin dhe personalizimin e të mësuarit.

1. Krijimi i hapësirave të mësimit, kërkimit dhe hapësirave sociale që mbështesin përkatësinë në një bashkësi akademike;
2. Sigurimi i mundësive për praktikë profesionale në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, me nënshkrimin e rreth **40 marrëveshjeve** me ndërmarrje dhe institucione publike e private;
3. Ofrimi i orientimit në karrierë dhe zhvillimi i aftësive të punësimit në një mënyrë që është e arritshme për të gjithë studentët gjatë gjithë kohës së tyre të studimit në FGjH;



Risi: FGjH është fakulteti i parë në UT me një platformë të drejtëpërdrejtë me bizneset për punësimin e studentëve <https://pnfgjhb.net/>

Platforma Ndërvepruese Fakulteti i Gjuhëve të Huaja-Biznes



The screenshot shows the homepage of the platform. At the top left is a circular logo featuring a building. The navigation menu includes 'Kryefaqja', 'Ofertat e Punëve', 'Bizneset', 'Kandidatët', and 'Faqet'. There are buttons for 'Identifikohu / Regjistrohu' and 'FGJH'. The main heading reads 'Platforma Ndërvepruese Fakulteti i Gjuhëve të Huaja-Biznes' with the tagline '“Sot Student ,Nesër Profesionalist”'. Below this is a search section with a text input 'Titulli i punës...', a location dropdown 'Vendndodhja', and a red 'Kërko' button. At the bottom, it lists search results: 'Përkthyes, Guidë, Copywriter, Content Writer, Mësues, Freelancer, PR'. On the right side of the screenshot, there are logos for the University of Tirana and the Faculty of Foreign Languages.

Në këtë platformë janë
regjistruar:
Rreth 40 biznese
Mbi 200 studentë

Risi: Ngritja e Zyrës së Psikologut

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja i kushton kujdes të veçantë nevojave të studentëve të tij duke u ofruar edhe shërbimin e Psikologut që prej fillimit të vitit 2022, me dy psikologe profesionale që kontribuojnë në krijimin e një mjedisi të sigurt dhe të shëndetshëm nga ana psikologjike, jo vetëm për studentët, por edhe stafin akademik dhe ndihmës akademik edhe duke u përfshirë në ekipe pune në të mirë të shëndetit psikologjik të studentëve tanë.

Psikologët ofrojnë seanca këshilluese për çdo student që dëshiron të lërë një takim si edhe duke organizuar leksione të hapura.

Dëshironi të flisni me një psikolog?

Ilirjeta, psikologja e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja të pret në zyrën e saj në Godinën A, kati i dytë, çdo ditë në orën 9:00-14:00

Kliko mbi QR Code për të lënë një orar takimi.



Universiteti i Tiranës
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

ZYRA E PSIKOLOGUT
Zhvillon leksionin e hapur me temë:
"Dita Ndërkombëtare e Shëndetit Mëndor"
"Rëndësia e Psikologut në Fakultet"

Dita Ndërkombëtare e Shëndetit Mëndor

Psikologe:
Ilirjeta Metushi
Pamela Kofsha

13 Tetor, 2023 | 12:00
Salla Evropa



Universiteti i Tiranës
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

TEMA: PSIKOLOGU DHE ROLI I TIJ
NË MJEDISËT E FAKULTETIT

25/11/2022
10:00
Salla "Evropa"

Psikologe:
Ilirjeta Metushi
Pamela Kofsha



Universiteti i Tiranës
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Menaxhimi i stresit dhe përdorimi me efektivitet i teknikave të caktuara për ekuilibrimin e tij

ORA 13:30
DATË 11.01.2024
SALLA "EVROPA", KATI I, GODINA B



Universiteti i Tiranës
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Tema: Menaxhimi i ankthit para provimeve.

Salla Evropa
Data: 09.05.2022
Oru: 11:30

Psikologe:
Ilirjeta Metushi
Pamela Kofsha



Universiteti i Tiranës
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Tema: Vetëbesimi dhe menaxhimi i emocioneve gjatë mbrojtjes së diplomës.

Data: 30/05/2022
Oru: 13:00
Salla: Evropa

Psikologe:
Ilirjeta Metushi
Pamela Kofsha





5. Zhvillimi i aftësive kërkimore të studentëve

Trajnimi dhe Mentorimi i Studentëve
për kërkimin shkencor



Jemi të lumtur të njoftojmë se, në thirrjet direkte për projekt ide që Bashkia e Tiranës hap në kuadër të shpalljes "Tirana Kryeqyteti i të Rinjve Europeanë" Klubi studentor i Artit dhe i Muzikës i Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës, në bashkëpunim me Agjencinë Universitare të Frankofonisë (AUF) ka fituar projektin:

"Festivali i të Rinjve të Ballkanit Perëndimor"



Qyteti i Tiranës, në një vrrall të plotë kulturor, do të mbledhë për një javë të rinj frankofonë nga i gjithë rajoni i Ballkanit Perëndimor.

Ne duam të krijojmë një hapësirë për shkëmbime mes të rinjve në një atmosferë miqësore duke përdorur gjuhën frëshe si mjet komunikimi.

Një gamë e gjerë aktivitetesh do t'u ofrohet pjesëmarrësve mbi tematikat e dialogut ndërkulturore dhe bashkëpunimit rajonal, duke filluar nga organizimi i stelseve për krijimin e afishave të dialogut ndërkulturore, tek realizimi i videove të mesazheve të përgjithshme të aktivitetëve kulturorë.

Gjithçka do të përfundojë me stil me një mbledhje gala që bashkon talentet dhe energjitë e të rinjve frëngjishtfolës.



**KESHILLI STUDENTOR I FAKULTETIT
TË GJUHËVE TË HUAJA ORGANIZON:**

**KONFERENCA
STUDENTORE**

**TË NXENIT NË SHEK. XXI.
PROBLEMATIKAT DHE PERSPEKTIVAT**

**DATA TË RËNDËSISHMË:
DORËZIMI I ABSTRAKTEVE: 30.04.2022
NJOFITIMI I PRANIMIT: 07.05.2022
DATA E KONFERENCËS: 12.05.2022**

Akset e konferencës:
 • Gjuhësi e komunikimit
 • Didaktika e gjuhëve të huaja
 • Letërsi
 • Përkthim/Interpretim
 • Zhvillimi i qasjeve të reja të kërkimit

Për të aplikuar skanoni barkodin ->





- Studentët janë mentoruar për pjesëmarrje në kërkim shkencor dhe tashmë ata kanë krijuar traditën e organizimit të Konferencës Studentore të përvitshme në FGjH-UT;
- Grupi i Studentëve të Klubit të Artit dhe Muzikës janë mentoruar në realizimin e projektit të tyre: *“Festivali i të Rinjve të Ballkanit Perëndimor”*, shpallur fitues në thirrjen e Bashkisë Tiranë në kuadër të *“Tirana Kryeqyteti i të Rinjve Europeanë”*.
- Për rritjen e aftësive kërkimore të studentëve, janë zhvilluar trajnime mbi shkrimin akademik dhe citimet e referencave në artikuj.



Forume me Biznese nga Dhomat e Huaja të Industrisë

Për të përmirësuar njohuritë dhe aftësitë e studentëve në kërkim, sipërmarrje, vendimarrje, janë organizuar Forume me Biznese nga Dhomat e Huaja të Industrisë në vend.



6. Zhvillimi i Kurrikulës



Gjatë vitit akademik 2022-2023 është realizuar :

**Riorganizimi
në masën nën 20%
i të gjithë programeve
ekzistuese Bachelor në FGjH**

**Riorganizimi
në masën mbi 20%
i programit
Master i Shkencave në “Gjuhë
dhe Komunikim Ndërkulturor
dhe Turistik”
me emërtimin e ri:
“Komunikim Ndërkulturor
dhe Turistik Trigjuhësh”**

Akreditimi i programeve

- Akreditimi me sukses i 8 (tetë) programeve të studimit të ciklit të parë Bachelor.
- Në proces akreditimi programet e studimit të ciklit të dytë Master.

Gjatë vitit akademik 2022-2023 është realizuar çelja e programeve të reja të studimit:



Diplomë

Bashkëpunim me Universitetin Ionian, Korfuz dhe Departamentin e Gjuhës Greke e Departamentin e Gjuhës Angleze

Bachelor me Profil në Përkthim dhe Interpretim në Gjuhën Greke dhe Angleze



Diplomë e dyfishtë

Bashkëpunim me Universitetin Sorbonne Paris Nord dhe Departamentin e Gjuhës Frënge

Master i Shkencave në Trajtimi Automatik i Gjuhëve, specialiteti Trajtim Automatik dhe Gjuhësor i Dokumenteve të Shkruara

Aplikime për programe të reja studimi:

Bachelor

- ***“Gjuhë dhe Kulturë Frënge dhe Kineze”***

Bachelor

- ***“Përkthim dhe Interpretim në gjuhën ruse dhe angleze”***

Bachelor

- ***“Bachelor në Gjuhën Frënge dhe Gjuhën e Shenjave Shqipe”***

Master

- ***“Mësuesi Gjuhë e Huaj, Gjuhë Spanjolle”***

Shtimi i lëndëve ekstrakurrikulare

Sportet



Universiteti i Tiranës
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

EDUKIMI FIZIK DHE SPORT

Si lëndë ekstrakurrikulare
për semestrin e dytë
2023-2024

Bëhu pjesë e skuadrës FGJH - UT!

Zgjidh dhe ti disiplinën sportive duke skanuar QR Coden:



Afati i aplikimeve mbyllet me datë 14/02/2024.
www.fgjh.edu.al

Gjuhët e huaja të rajonit



Universiteti i Tiranës
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Ceremonia e diplomimit të studentëve të kursit ekstrakurrikular të gjuhës maqedonase



15.05.2024 10:00
Salla "Rozafa"

Në maj 2024, përfundoi kursi **3-mujor** ekstrakurrikular i gjuhës maqedonase, në bashkëpunim me Universitetin "St. Cyril and Methodius" të Shkupit të Maqedonisë së Veriut, ku morën certifikatë **5** studentë.



7. Zhvillimi i metodologjive të mësimdhënies dhe të nxënësve

Vlerësimi dhe mbështetja e inovacionit në mësimdhënie


Me ngritjen e Degës së Trajnimeve dhe Inovacionit Pedagogjik në 2022 është strukturuar organizimi i trajnimeve sipas grupeve të interesit (personel akademik, administrativ, studentë, doktorantë, palë të treta) të grupuara në tematika si:

Përdorimi i teknologjive të reja dhe i platformave virtuale në mësimdhënie

Teknikat dhe specifikat mbi profilet e profesionit që formohen në FGJH (përkthyes, mësues, guida turistike, etj.)

Trajnime për Zhvillim Profesional të Vazhdueshëm (CPD):

10 module të akredituara
268 mësues të certifikuar



Trajnime për rritjen e aftësive të mësimitdhënies

Universiteti i Tiranës
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja
Dega e Trajtimeve dhe Inovacionit Pedagogjik
X
Dega e Teknologjisë dhe Informacionit

Mësimdhënia nëpërmjet platformës TEAMS, ChatGPT & Inovacionet e AI

19.10.2023
13:30
Salla "Evropa"

SKANO QR KODIN

"Vocabprofile", përvetësimi dhe përforcimi i fjalorit në gjuhë të huaj përmes të mësuarit digjital

Trajnim për aktorët e procesit të mësimitdhënies
Në kuadër të bashkëpunimit mes universiteteve brenda dhe jashtë vendit.

Trajnuesë:
Prof. Assoc. Dr. Klementina Shiba, UT
Dr. Juliana Cyfeku, UNIKO Dr. Edlira Xega, UNIKO

21 Nëntor 2023 11:00 - 14:00
Salla: 214

Universiteti i Tiranës
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja
Dega e Trajtimeve dhe Inovacionit Pedagogjik
X
Zyra e Psikologut

ofron modulën e informimit për personelin akademik me temë:

TEKNIKA TË MENAXHIMIT TË SITUATAVE TË VËSHITURA ME STUDENTËT

ra 13:30
14.12.2023
Salla "Europa", Kati I, Godina B, FGJH

Universiteti i Tiranës
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

**Module informimi për pedagogët
Viti akademik 2023-2024**

Nr	Data	Ora	Temat e diskutimit
1	19.10.2023	13:30-15:30	Mësimdhënia nëpërmjet platformës TEAMS/përdorimi i teknologjive digjitale.
2	20.11.2023	13:30-15:30	Aplikimi i qasjes së mësimitdhënies me zhvillimin e projekteve dhe zgjidhje problemesh.
3	14.12.2023	13:30-15:30	Teknika të menaxhimit të situatave të vështira me studentët.
4	15.01.2024	13:30-15:30	Strategji të mësimitdhënies për të përmirësuar motivimin e studentëve gjatë studimeve.
5	20.02.2024	13:30-15:30	Vlerësimi në bazë kompetencash i studentëve.

MODUL TRAJNIMI

Kanë filluar regjistrimet për:

HARTIMI DHE REALIZIMI I NJË PROJEKTI NË MËSIMDHËNIEN NË KLASË DHE NË DISTANCË
(1 KREDIT)

MODUL TRAJNIMI

Kanë filluar regjistrimet për:

MENAXHIMI I KLASËS DHE I KONFLIKTEVE, MIRËQËNIA E NXËNËSVE NË KLASË
(2 KREDITE)

MODUL TRAJNIMI

Kanë filluar regjistrimet për:

MËSIMDHËNIA DHE TË NXËNIT BAZUAR NË KOMPETENCA DHE PLANIFIKIMI I VEPRIMTARIVE MËSIMORE SIPAS NEVOJAVE TË VEÇANTA DHE NIVELEVE TË NDRYSHME MËSIMORE
(3 KREDITE)

8. Sigurimi i Cilësisë



Akreditimi i Programeve të Studimit Bachelor

Programet Bachelor të ofruara nga të gjithë departamentet në FGJH-UT kanë kaluar me sukses procesin e vlerësimit të jashtëm 2018-2021 duke përmbushur plotësisht standardet e vlerësimit.



Akreditimi i Programeve të Studimit Master

Në proces...

- **Master i shkencave në Përkthim teknik-letrar dhe interpretim në gjithë departamentet e FGJH-UT;**
- **Master i shkencave në Mësuesi e Gjuhës Angleze për arsimin e mesëm të lartë ;**
- **Master i shkencave në Mësuesi në Gjuhën Turke për arsimin e mesëm të lartë.**

Dega e Cilësisë dhe Kurrikulës është ngritur në 2021 dhe veprimtaritë e kryera nga NJSBC janë:

- Koordinim dhe ndërmjetësim me GVB-të, ekspertët e jashtëm dhe ASCAL për vlerësimin e jashtëm, për akreditimin e programeve Bachelor në të gjitha gjuhët dhe profilet e ofruara në FGjH.
- Trajnime dhe takime informuese me studentët e FGjH mbi rëndësinë e plotësimit të pyetësorit për vlerësimin e lëndës dhe pedagogut.
- Menaxhim i procesit të Vlerësimit nga Studentët nëpërmjet Pyetesorëve (organizim, shpërndarje, analizë).
- Mbështetje në procesin e punës mbi riorganizimin ose hapjen e programeve të reja.
- Hartimi i raporteve semestrale të vlerësimit nga studentët.
- Hartimi i raportit vjetor për sigurimin e cilësisë.



VLERËSIMI NGA STUDENTËT

Takime informuese
Zyra e Cilësisë dhe Kurrikulës në
bashkëpunim me Këshillin Studentor



Datat: 18/19/20 prill 2023
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja
njsbc.fgjh@unitir.edu.al

Organizimi i Forumit të Cilësisë në Arsimin e Lartë për Evropën Qëndrore dhe Lindore

EN EUROPE CENTRALE ET ORIENTALE (FFQ-ECO)

6-7 DÉCEMBRE 2023


À TIRANA, ALBANIE



Risi: FGjH është fakulteti i parë në UT me digjitalizimin e Arkivës dhe Bibliotekës

Arkiva digjitale mundëson përmirësimin e proceseve të ndryshme nëpërmjet servirjes së informacionit në një kohë më të shpejtë dhe fleksibilitet më të lartë.

Biblioteka digjitale përmban rreth 15 mijë libra, që përfaqëson një platformë gjithëpërfshirëse dhe miqësore për përdoruesit duke lehtësuar aksesin në një koleksion të gjerë librash digjitalë në: letërsi, didaktikë klasike, artikuj, revista akademike, punime kërkimore, përmbajtje multimediale, etj.





9. Zhvillimi i qasjes ndërdisciplinore dhe bashkëpunuese në kërkim

9.1 Promovimi i personelit akademik me tituj dhe grada shkencore

Duke filluar nga viti akademik 2021-2022, prioritet maksimal ka patur mbështetja e promovimit të personelit akademik me grada e tituj si edhe u hartuan projekte në bazë të profilit dhe nevojave të njësisë bazë përkatëse.

Fuqizimi i Zyrës së Kërkimit Shkencor dhe Botimeve (3 personel) ka lehtësuar ndjekjen e procedurave me përpikmëri dhe në afate të përshpejtuara. Në tre viteve akademike janë realizuar:

- | | | |
|--|---|--|
| 65 Doktorantë, të regjistruar në programin e studimit të ciklit të tretë në FGjH | ➔ | Shpallur fitues për tre vite duke nisur nga viti akademik 2021-2022, me ri-hapjen e procesit |
| 13 kandidatë kanë fituar gradën “Doktor i Shkencave” | ➔ | 5 prej tyre pedagogë në FGjH, të gjendur në një proces të vonuar |
| 38 kandidatë kanë fituar titullin “Profesor i Asociuar” | ➔ | 20 prej tyre pedagogë në FGjH |
| 3 kandidatë kanë fituar titullin “Profesor” | ➔ | 2 prej tyre pedagogë në FGjH |

9.2 Ngritja e grupeve mësimore-kërkimore


Janë krijuar 16 grupe mësimore-kërkimore nga çdo departament të cilët kanë plan veprimi dhe realizojnë aktivitete të shumta kërkimore shkencore dhe në mbështetje të studiuesve të rinj.

Departamenti i Gjuhës Frënge	Departamenti i Gjuhës Italiane	Departamenti i Gjuhës Gjermane	Departamenti i Gjuhës Spanjolle	Departamenti i Gjuhës Greke	Departamenti i Gjuhëve Sllave e Ballkanike
Fushat Kërkimore					
Mësimdhënie	Mësimdhënie	Mësimdhënie	Letërsi-Komunikim	Gjuhësi-Përkthim	Gjuhësi-Didaktikë i Degës së Gjuhës Turke
Letërsi	Letërsi, Komunikim	Letërsi dhe Qytetërim	Gjuhësi		Gjuhësi-Përkthim i Degës së Gjuhës Ruse
Gjuhësi, Përkthim, Komunikim	Gjuhësi, Përkthim dhe Interpretim	Gjuhësi dhe Komunikim Përkthim dhe Interpretim			



Didaktikë e Gjuhëve të Huaja
Përkthim
Letërsi
Linguistikë

9.3 Risi: Aktivitete në mbështetje të studiuesve të rinj





9.4 Fuqizimi i Revistës Shkencore FGjH

Realizuar:

- Janë botuar çdo vit 2 (dy) Revista Shkencore FGjH duke filluar nga viti 2021;
- Janë realizuar 3 botime *proceeding books* të kumtesave të konferencave ndërkombëtare të organizuara nga FGjH;
- Është aplikuar në mënyrë rigoroze recensimi shkencor *double blind review* e cila ka garantuar ruajtjen e cilësisë së botimeve të revistës sonë.

Në proces:

- Publikimi i Revistës Nr. 8/2024, me hulumtime nga personeli akademik;
- Rankimi i Revistës Shkencore FGjH si dhe është në procesin e regjistrimit në Regjistrin Kombëtar të Revistave Shkencore (administruar nga AKKSHI);
- Aplikimi për kërkimin e së Drejtës së Botimit Online të revistës sonë shkencore.



Në proces...

9.5 Ngritja e Zyrës së Projekteve dhe ofrimi i Paketës së Projekteve Kërkimore

Në fillim të vitit akademik 2021-2022 u ngrit Dega e Projekteve si njësi mbështëtese për kërkuesit shkencor në projekte kombëtare e ndërkombëtare.

Risi në FGJH ishte Thirrja 2022-2024 për financim të projekt-ideve të Departamenteve në FGJH-së me fonde të kërkimit shkencor FGJH.

- ✓ 13 Projekte fituese nga 7 Departamente
- ✓ 62 Pedagogë pjesëmarrës në projektet e kërkimit
- ✓ 12 Doktorantë pjesë e grupeve të punës
- ✓ Rezultat i këtyre projekteve janë:
 - botime të artikujve shkencore
 - botime të udhëzuesve e manualeve për studiuesit e rinj.

U ngrit tradita e përvitshme “Dita e Kërkuesit Shkencor”, ku personeli akademik i përfshirë në projekte prezanton punën dhe risitë e kërkimit.



Projekte të Kërkimit Shkencor në thirrje kombëtare e ndërkombëtare

Kombëtare

- 6 Projekte → Universiteti i Tiranës
- 2 Projekte → AKKSHI



Ndërkombëtare

- 8 Projekte → AUF
- 4 Projekte → READ
- 2 Projekte → ERASMUS+ KA1; KA2

Pjesë e grupeve të punës:

- 32 Pedagogë të FGJH-së
- 5 Doktorantë
- 11 Personel Administrativ

Produkt i këtyre projekteve janë: botime të artikujve shkencore, botime të udhëzuesve e manualeve me praktikat më të mira, etj.



Projekte të Infrastrukturës kërkimore dhe ndërkombëtarizimit të programeve

Përshkrimi i përmirësimeve teknologjike, përmirësimeve laboratorike dhe investimeve të tjera për të mbështetur aktivitetet mësimore dhe kërkimore.

Mbështetje Infrastrukturore nga:

- **Universiteti i Tiranës**
- **3** Projekte → **Ministria e Arsimit**
- **1** Projekt → **AKKSHI**

Në thirrjen nga AKKSHI/2024 kemi aplikuar për ngritjen e një Laboratori të ri:

“LangTech Hub: Inkubatori Universitar për Inovacionin në Gjuhë, Përkthim dhe Turizëm”


Janë ngritur Laboratorët :

- **8** laboratorë të rinj të didaktikës;
- **3** laboratorë të rinj të përkthimit dhe mësimdhënies së gjuhëve të huaja;
- **1** laborator i ri fonetikës;
- **1** laborator për trajnime të vazhduara për mësuesit, përkthyesit, ndërmjetësit kulturor;
- **3** Laboratorë → Për programin Bachelor & Master në gjuhën e shenjave;
- **1** Laborator → Për programin Master i Shkencave në Trajtimi Automatik i Gjuhëve;
- **1** Laborator → DiPLing dedikur kërkimit shkencor për studentët e ciklit të tretë Doktoratë;
- **6** salla të pajisura me teknologjinë më të fundit;



- U rinovua infrastruktura elektronike në të gjithë auditorët e FGjH-së;
- Janë instaluar 38 tabela interaktive dhe janë pajisur sallat me sisteme audio;
- U modernizua Departamenti i Gjuhës Angleze, për një mjedis profesional universitar;
- Departamentet dhe zyrat administrative janë pajisur me kompjutera të rinj në funksion të punës, laptop, fotokopje, scanner;
- Mbulimi me wifi i të gjithë mjediseve të FGjH-së me akses përdorimi për personelin dhe studentët;
- U ngrit Qenda Multifunksionale e Këshillit Studentor.

Përmirësimi i infrastrukturës kërkimore





10. Zgjerimi i partneriteteve

Për të mbështetur mësimdhënien, të nxënit, punësimin e studentëve



Mbi 40 Marrëveshje të nënshkruara...

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja ka në fokus lidhjen e urave të bashkëpunimit me: institucione arsimore parauniversitare kombëtare, ndërmarrje private, institucione kulturore e shoqata të ndryshme, shtëpi botuese, agjenci dhe operatore turistikë, etj., të cilët vinë në ndihmë të studentëve për:

- kryerjen e praktikave mësimore
- trajnime mbi shërbimet që ofrohen në këto institucione
- seminare
- leksione
- konferenca
- promovime të përkthimeve të reja
- takime letrare me shkrimtarë, poetë e përkthyes
- përfshirjen në projekte kërkimore-shkencore të përbashkëta
- ngritja dhe zhvillimi i mëtejshëm i njohurive profesionale dhe akademike
- ngritja e kapaciteteve të studentëve si dhe shkëmbimi i praktikave më të mira në fushat me interes të përbashkët midis palëve.





Bashkëpunimet ALUMNI

Me ngritjen e rrjetit të ambasadorëve të markës “Alumni” janë bërë aktive bashkëpunimet me profesionistë të afirmuar për:

- Leksione të hapura për stafin dhe studentët;
- Trajnime profesionale;
- Mbështetje për Shkolla Verore/Dimërore;
- Praktika Mësimore.

Universiteti i Tiranës
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

**NJIHUNI ME HISTORI SUKSESI
TË ALUMNI TË FAKULTETIT TË
GJUHËVE TË HUAJA**

Të ftuar ish studentë të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja të cilët do t'ju flasin për sukseset e tyre profesionale në fushën e mësimdhënies, përkthimit, interpretimit, komunikimit turistik, si edhe të sipërmarrjeve të ndryshme në këto fusha.

**TË BËHESH
MËSUES**

TË FTUAR SPECIALË PËR T'JU NDIHMUAR
NË KARRIERËN TUAJ PROFESIONALE SI
MËSUES TË SË ARDHMES

14/12/2022 12:30
Salla "Europa"





11. Ndërkombëtarizimi i FGjH-së

Ndërkombëtarizimi i kurrikulës dhe i procesit të mësimdhënies dhe të nxënies si dhe ofrimi i programeve dhe diplomave të përbashkëta

Marrëveshje me Universitete Ndërkombëtare

Në kuadër të Ndërkombëtarizimit të Universitetit të Tiranës dhe rritjes së kontakteve me partnerë të huaj në sferë të arsimit të lartë, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja ka kontaktuar me Universitete Ndërkombëtare, duke lidhur Marrëveshjeje Kuadër për bashkëpunim akademik në fushën e didaktikës, kërkimit shkencor dhe mobiliteteve të ndryshme për personelin akademik dhe studentët:

Rreth **40** marrëveshje aktive të nënshkruara nga Universiteti i Tiranës, nga ku merr të drejta edhe Fakulteti i Gjuhëve të Huaja.

Rreth **20** marrëveshje aktive të nënshkruara, specifikuar për mobilitetin e studentëve dhe personelit të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja.

Austri Bullgari Çeki Francë Gjermani Greqi Hungari Itali Kroaci Letoni Poloni Sllovaki Spanjë ...



**Në 3 vite
akademike:**

Erasmus+

Mbi **150** studentë të FGjH-së kanë zhvilluar mobilitete në
Universitetet më të mira të Evropës

Mbi **110** pedagogë dhe staf ndihmës
administrativ të FGjH-së kanë zhvilluar
mobilitete në Universitetet më të mira të
Evropës

Mbi **100** profesorë të huaj
kanë vizituar FGjH në kuadër të
pjesëmarrjes në konferenca,
seminare shkencore, leksione
të hapura, javë studimore e
mësimdhënieje



Aktivite social-kulturore me personelin akademik dhe administrativ



Pogradec



Berat



Meteora

